




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRIA E DREJTËSISË



UNIVERSITETI  
**BARLETI**

FAKULTETI I EKONOMISË, QEVERISJES  
DHE DREJTËSISË  
KLINIKA LIGJORE "BARLETI"

Nr. 396 Prot.

Tiranë, më 21 /01/2021

Nr. 50 Prot.

Tiranë, më 21 /01/2021

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE**

Sot më datë, 21.01.2021, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

**Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas**, me adresë: Bulevardi "Zog I",  
Tiranë, përfaqësuar nga **Ministri, Znj. Etilda GJONAJ**;

*dhe*

**Universitetit BARLETI**, me adresë: Rr: Kosovarëve, Nr.37, Kodi Postar 1019, Tiranë,  
licencuar me VKM Nr.157, datë 12.08.2005, pjesë e "BARLETI GROUP" Sh.p.k, themeluar me  
vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nr.32511, datë 06.12.2004, me NUIS  
K52115006H, përfaqësuar nga **Administratori i Deleguar, Prof. Asoc. Dr. Arbi AGALLIU**

Më poshtë të quajtura palët, të cilat, nisur nga dëshira për të institucionalizuar bashkëpunimin e  
tyre në fusha me interes të përbashkët, bien dakord si më poshtë:

Më poshtë të quajtura palët, të cilat, nisur nga dëshira për të institucionalizuar bashkëpunimin e tyre në fusha me interes të përbashkët, bien dakord si më poshtë:

#### Neni 1

#### **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Pjesën V, në Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” neni 8, paragrafi 2, pika “e”, në Ligjin Nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet e tjera të kësaj fushe.

#### Neni 2

#### **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshje është ofrimi i ndihmës juridike parësore sipas përcaktimeve në këtë marrëveshje.

#### Neni 3

#### **Përkufizime**

Në këtë marrëveshje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ndihma juridike parësore” ka të njëjtin kuptim sipas nenit 3 të pikës ”b” të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. “Palët” janë Ministria e Drejtësisë - Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas - dhe Universiteti pranë të cilit është ngritur Klinika Ligjore “BARLETI”.
3. “Regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve” është formati i regjistrimit i miratuar nga Ministri i Drejtësisë me Urdhër Nr. 225, datë 25.03.2019.
4. “Sistemi unik i të dhënave” është sistemi elektronik online për ngarkimin e të dhënave, i aksesueshëm nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

#### Neni 4

#### **Të drejtat dhe Detyrimet e**

#### **Universitetit BARLETI**

1.Universiteti BARLETI, pranë të cilit është ngritur klinika ligjore, do të ofrojë ndihmën juridike parësore sipas procedurave ligjore për dhënien e ndihmës juridike parësore të parashikuara në

nenin 17 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Klinika ligjore do të mbajë, plotësojë dhe përditësojë regjistrin e vetëdeklarimeve të personave që kanë aplikuar të përfitojnë ndihmën juridike parësore. Regjistri do të mbahet në mënyrë elektronike. Ngarkimi i të dhënave do të bëhet edhe në sistemin Unik të të dhënave sipas akteve nënligjore të miratuara për këtë qëllim,

3. Klinika ligjore do t’i dërgojë të dhëna periodike çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar / përfituar ndihmën juridike. Të dhënat do të dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.

4. Përzgjedhja e studentëve që do të përfshihen në ofrimin e ndihmës juridike parësore pranë klinikës ligjore do të bëhet sipas rregullave të Klinikës Ligjore “BARLETI” të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, në Departamentin e Drejtësisë, të Universitetit BARLETI. Në çdo rast numri i studentëve nuk mund të jetë më shumë se numri i lejuar për grup sipas rregullave të Fakultetit dhe Klinikës së Ligjit.

5. Klinika ligjore mund të japë opinione, sugjerime, t’i kërkojë informacione apo ndihmë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për çështje/probleme që lidhen me ofrimin apo përmirësimin e ndihmës juridike parësore.

6. Klinika ligjore në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë/DNJF ndërmerr fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut veçanërisht informimin e studentëve të universitetit/fakultetit mbi kriteret dhe kushtet e përfitimit të ndihmës juridike parësore.

7. Klinika ligjore ka të drejtë të përfitojë financime nga donatorë të ndryshëm të cilët ofrojnë mbështetje në fushën e Ndihmës Juridike falas.

8. Klinika ligjore ofron zyra të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar. Klinika mban arkivin elektronik dhe është e pajisur me mjetet minimale të punës. Për aq sa është e mundur, Klinika ofron shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas mundësive të saj dhe sipas standarteve të përcaktuara në Urdhërin Nr. 531 Prot., datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të Shërbimeve të Ndihmës Juridike”.

9. Klinika do të përcjellin kërkesat për ndihmë juridike parësore pranë Qendrave për rastet e kategorive të veçanta, sipas ligjit, kur kjo e fundit nuk ka eksperiencën në fusha specifike të ofrimit të ndihmës juridike.

10. Klinika mund të bashkëpunojë punën me ofrues të tjerë të ndihmës juridike parësore.

## Neni 5

### **Të drejtat dhe Detyrimet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas**

1. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF) do të ofrojë kushte për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë klinikës ligjore, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.
  - a. DNJF trajnon studentët e përfshirë pranë klinikave të ligjit të paktën një herë në vit.
  - b. DNJF ofron mundësi për kryerjen e praktikave të punës pranë kësaj të fundit dhe pranë qendrave të administruara prej saj. Numri i studentëve që do të ofrohet mundësi praktikë punë do të jetë i barabartë për çdo IAL, por jo më shumë se 5 pesë studentë. Praktikrat do të jetë (3) tre mujore. Përzgjedhja e studentëve bëhet nga përfaqësuesi/koordinatori i klinikës bazuar në përfomancën dhe angazhimin e treguar prej studentëve, praktikantë pranë klinikës së ligjit.
  - c. Drejtoria merr përsipër të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me OJF-t e autorizuara dhe të cilat kanë marrë fonde nga buxheti i shtetit të përfshijnë studentët e IAL-vë në praktika, trajnime pranë këtyre të fundit (ojf-ve), në mënyrë që studentët të kenë mundësi praktike të ofrimit të ndihmës juridike parësore edhe për kategoritë e posaçme të ligjit.
2. Për aq sa është e mundur do të sigurojë informacione, këshillime apo ndihmën e kërkuar nga klinika ligjore për zgjidhjen e problemeve me të cilat do të përballet kjo e fundit gjatë ofrimit të ndihmës juridike parësore.
3. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka të drejtë të kërkojë nga klinika ligjore informacione apo të dhëna periodike.
4. Mbështet kliniken ligjore dhe me kërkesë të kësaj të fundit merr pjesë në fushata për ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të publikut.
5. DNJF angazhohet për të krijuar rrjetin e klinikave të ligjit (ofruesve të ndihmës juridike parësore Qendra, OJF) duke ndihmuar në përcjelljen e eksperiencave më të mira, nëpërmjet organizimit të takimeve periodike sipas akteve nënligjore dhe sistemit të menaxhimit të çështjeve.
6. DNJF angazhohet për bashkëpunim dhe koordinim për realizimin e takimeve të përbashkëta me donatorë të ndryshëm nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim dakordësimin dhe financimin e klinikave të ligjit apo projekteve që këta të fundit mund të zbatojnë.

## Neni 6

## **Komunikimes palëve**

1. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacione, të dërgojnë apo marrin të dhëna të ndryshme përmes postës elektronike apo çdo formë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Për këtë qëllim palët do të caktojnë personat e kontaktit me të dhënat si më poshtë:
  - Për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas: Personi i kontaktit Z. Ilberjan Durmishi nr. Cel. 0675500812; e-mail: [ilberjan.durmishi@drejtesia.gov.al](mailto:ilberjan.durmishi@drejtesia.gov.al); [dnjf@drejtesia.gov.al](mailto:dnjf@drejtesia.gov.al).
  - Për klinikën ligjore: Personi i kontaktit znj. Elona Bano, nr. Cel. 0692155745 e-mail: [lae.co@umb.edu.al](mailto:lae.co@umb.edu.al)
3. Në çdo rast palët njoftojnë për ndryshimin e të dhënave dhe personit të kontaktit.

### Neni 7

#### **Mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti**

1. Palët marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave apo informacioneve me të cilat janë vënë në dijeni gjatë dhënies së ndihmës juridike parësore.
2. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të kërkuesve të ndihmës juridike parësore do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

### Neni 8

#### **Ndryshimi dhe zgjidhja e marrëveshjes**

1. Palët janë të lira të propozojnë ndryshimet e kushteve të kësaj marrëveshjeje.
2. Me njoftimin me shkrim, çdo palë në çdo kohë mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje pasi të këtë njoftuar paraprakisht palën tjetër.

### Neni 9

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që lindin mes palëve do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre. Nëse kjo nuk është e mundur palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 10

### Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit mes palëve.

Neni 11

### Të ndryshme

1. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.
2. Çështjet të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë marrëveshje do të rregullohen sipas Pjesës V, Titulli I, të dispozitave të Kodit Civil të miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet e tjera të kësaj fushe.

**PËR**

**MINISTRINË E DREJTËSISË**

**DREJTORINË E NDIHMËS**

**JURIDIKE FALAS**

përfaqësuar nga

**MINISTRI**

**ZNJ. ETILDA GJONAJ (SALIU)**



**PËR**

**UNIVERSITETIN BARLETI**

përfaqësuar nga

**ADMINISTRATORI I DELEGUAR**

**Prof. Asoc. Dr. Arbi AGALLIU**

